

*Ux. prot. 1095*

*dt. 21/07/08*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT**  
**MINISTRI**

**URDHËR**

Nr. 110 datë 14/07/2008

*2. Reskri  
te procesit te luft  
me influencim e rregullon*

**“PËR  
MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E RREGULLORES  
“PËR LIÇENSIMIN E PERSONELIT FLUTURUES”**”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 dhe të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9489, datë 13.03.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Dispozitat për Zhvillimin Pranimin dhe Zbatimin e Kërkesave të Përbashkëta të Aviacionit, (JAA), ligjit nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit European dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit European”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit:

**URDHËRON:**

1. Rregullat dhe procedurat e liçensimit miratohen me këtë Urdhër, si e vetmja rregullore e vlefshme për liçensimin e personelit fluturues të avionëve dhe helikopterëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Duke filluar nga data 01/08/2008, të gjitha liçensat e pilotëve, kategorizimet dhe autorizimet e lëshuara, rivaliduara apo rinovuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, duhet të jenë në përputhje me kërkesat specifike të Rregullores.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, për zbatimin e këtij Urdhëri dhe Rregullores “Për Liçensimin e Personelit Fluturues”.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**SOKOL OLLDASHI**  
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT